



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**Kodi i lëndës: INF 450**  
**Lënda: Patologji e avancuar**

PROGRAMI I LËNDËS: Patologji e avancuar								
<b>Titullari i lëndës:</b>		<b>Fejzi Alushi</b> <i>Dr në Mjekësi Klinike</i> . _____						
<b>Ngarkesa:</b>	<b>ECTS</b>	<b>Orë mësimi në auditor</b>					<b>Studim individual</b>	<b>Totali</b>
		<b>Leksion</b>	<b>Seminar</b>	<b>Lab</b>	<b>Praktikë</b>	<b>Projekt klinik</b>		
	12	60	15	0	75	0	150	300
<b>Tipologjia e lëndës</b>		Disiplinë e formimit karakterizues të programit						
<b>Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda</b>		Viti I, Semestri I						
<b>Lloji i lëndës</b>		E detyrueshme						
<b>Programi i studimit</b>		Master Profesional në Infermieri Patologjike						
<b>Kodi i lëndës</b>		INF 450						
<b>Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës</b>		<a href="mailto:fejzi.alushi@univlora.edu.al">fejzi.alushi@univlora.edu.al</a> ,						

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**

<b>Përmbledhja</b>	<p>Në këtë modul studiohen problemet shëndetsore madhore që prekin popullatën adulte. Nëpërmjet uë integritit të njohurive mbi patologjitë kardio-vaskulare, respiratore, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, reumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike do të trajtohen standartet bashkëkohore mbi jetën e shëndetshme, mjedisin, reduktimin të faktorëve riskantë dhe parandalimin e sëmundjeve. Një vëmendje e veçantë do të kushtohet moshave të treta për sindromat më të shpeshta geriatrike. Roli i infermieres profesionale që kujdeset për pacientët adultë, do të fokusohet në kontekstin e individit, familjes dhe komunitetit.</p>
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të klasifikojnë dhe të diagnostikojë patologjitë kryesore kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, reumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .</li><li>• Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të integruar të pacientëve adultë me patologji kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, reumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .</li><li>• Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive të adultit.</li><li>• Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Të klasifikojnë dhe të diagnostikojë patologjitë kryesore kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, reumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .</li><li>• Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të integruar të pacientëve adultë me patologji kardiake, respiratore dhe endokrine, nefrologjike, reumatologjike, alergologjike, ureumatizmale, neurologjike, hematologjike dhe gastro-hepatologjike .</li><li>• Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive të adultit.</li><li>• Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.</li></ul>

### KONCEPTET THEMELORE

- Bazat fiziologjike të sëmundjeve të brëndshme
- Përkujdesjet shëndetësore gjatë gjithë jetës. Promocioni shëndetësor dhe parandalimi
- Njohja etiologjike, diagnostikimi, dhe trajtimi i sëmundjeve

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I	<b>Tema 1-</b> Historia natyrore e HTA, HTA esencial. HTA sekondar. Menaxhimi i krizës hipertensive në urgjencat spitalore dhe ambulatorore, studim rasti dhe studim i kartelës mjeksore  <i>HTA është një patologji shumë e përhapur në botë dhe sidomos në vendin tonë, e ndarë në tre kategori, me shkaktarë të ndryshëm, dhe aspect trajtimi kompleks.</i>	<sup>(1)</sup> Fq. 84-98 Vëllimi I	<i>Lexion një orë</i>
	<b>Tema 2-</b> Edema. Klasifikimi, etiopatogjeneza dhe trajtimi sipas shkaqeve, studim rasti dhe studim i kartelës mjeksore	<sup>(1)</sup> Fq. 84-98 Vëllimi I	<i>Lexion një orë</i>
	<b>Tema 3 -</b> Stenoza e valvules mitrale dhe stenoza e aortes, studim rasti dhe studim i kartelës mjeksore  <i>Stenozat janë ngushtime të enëve të gjakut ose të valvulave kardiake që sjellin shumë probleme tek pacientët, prek me shumë femrat dhe ka shkaktarë të ndryshëm, më I përmendur është ethja reumatizmale.</i>	<sup>(1)</sup> Fq. 27-32 Vëllimi I	<i>Lexion një orë</i>
	<b>Tema 4.</b> Regurgitimi mitral, aortal dhe prolapsi i valvules mitrale, studim rasti dhe studim i kartelës mjeksore	<sup>(1)</sup> Fq. 33-40 Vëllimi I	<i>Lexion një orë</i>



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Këto janë gjendje patologjike që shoqërohen me dëmtim të valvulës mitrale, aortale duke u quajtur ndryshe sindroma Barlow</i></p> <p><i>Seminar 1:HTA, Edema, stenoza mitrale, problemet aortale.</i></p>		<p><i>Seminar një orë</i></p> <p><i>Praktikë 5 orë</i></p>
II	<p><b>Tema 5.</b> Veset e fituara të zemrës. Etiopatogjeneza, klinika, dhe mjekimi i tyre, studim rasti në kartelën mjekësore 41-54</p> <p><i>Veset e fituara kardiake janë disa por më e shpeshtë në këto patologji është stenoza e aortës me rreth 25% te rasteve, prek më shumë meshkujt me 80% dhe ka trajtim afatgjat.</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 41-54</p> <p>Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p>
	<p><b>Tema 6.</b> Njohuri mbi veset e lindura te zemres (DIV, DIA, tetradra FalLOT, koarktacioni i aortes), studim rasti të patologjive kardiake, dhe studim i kartelës mjeksore 55-58</p> <p><i>Malformacionet kardiake zënë më shumë se 25% të malformacioneve të lindura humane, prekin më shumë meshkujt dhe fëmijët e nënave me moshë të madhe.</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 55-58</p> <p>Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p>
	<p><b>Tema 7.</b> Endokarditi infeksioz.Etiopatogjeneza, klinika, dhe mjekimi i tyre, studim rasti dhe studim i kartelës mjeksore</p> <p><i>Janë sëmundje bakteriale që karakterizohen nga ulceracionet në endokard. Dëmtohet më shumë ana e majtë e zemrës dhe më shumë pjesa e valvulave sidomos nga ethja reumatizmale.</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 41-44</p> <p>Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p>
	<p><b>Tema 8.</b> Perikarditet dhe miokarditet, kardiomiopatitë.Tamponada kardiake. Etiopatogjeneza, klinika, dhe mjekimi i tyre, studim rasti dhe studim i kartelës mjeksore fq 45-54</p> <p><i>Janë inflamacione të mureve kardiake, akute ose kronike nga shkaqe të shumta dhe me trajtim kompleks.</i></p> <p><i>Seminar 2: Veset e fituara dhe te lindura kardiake, endokrditet, peri dhe miokarditet</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 45-54</p> <p>Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Seminar një orë</i></p> <p><i>Praktikë 5 orë</i></p>
III	<p><b>Tema 9.</b> Sëmundja athero-sklerotike e zemrës, Angina pectoris.Studim rasti dhe studim i kartelës mjeksore, rehabilitimi i pacientit. 59-69</p> <p><i>Ateroskleroza është sëmundje e organizmit që manifestohet me grumbullimin e pllakëzave yndyrore në organizëm, dhe si pasojë mund të shkaktojë anginë e cila është dhimbje torakale ose stenocardia, vjen nga pakësimi I fluksit të gjakut në koronare.</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 59-69</p> <p>Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p>
	<p><b>Tema 10.</b> Infarkti akut i miokardit. Etiopatogjeneza, klinika,</p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 71-83</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>ndërlikimet e IAM dhe mjekimi i tyre</p> <p><i>Është një sindromë klinike si pasojë e anoksisë , një nekrozë akute, iskemike e miokardit me diametër mbi 1 cm 3.</i></p> <p><b>Tema 11.</b> Shkaqet e vdekjes se papritur dhe reanimimi kardio-pulmonar.</p> <p><i>Vdekja e papritur mund të përkufizohet si një vdekje e shpejtë që ndodh tek personat në dukje të shëndetshëm, gjatë aktivitetit normal, pa histori sëmundjeje, përfshin 15%-30% të vdekjeve në tërësi dhe më e lartë është në grupmoshat 0-6 muajsh, dhe 30-75 vjec.</i></p> <p><b>Tema 12.</b> Çrregullimet e ritmit dhe përcimit. Patologjitë e sistemit kardiovaskular në moshat e treta, Etiopatogjeneza, klinika, dhe mjekimi i tyre, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><i>Çrregullimet e ritmit dhe përcimit përfaqësojnë në vetvete një numër patologjish të konsiderueshme, që shpesh janë serioze, dhe duhen studiuar secila në vecanti, duke përmendur takikardia sinusale, bradiakardia sinuzale, ekstrasisatolat, takikarditë paroksizmale, fibrilacioni atrial, dhe ventricular, bllokun sinoatrial, atrioventricular etj.</i></p> <p><i>Seminar 3: Ateroskleroza, IAM, probl e ritmit</i></p>	<p>Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 108-110</p> <p>Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 99-108</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 111-116</p> <p>Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Seminar një orë</i></p> <p><i>Praktikë 5 orë</i></p>
IV	<p><b>Tema 13.</b> Insufiçenca kardiake, Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><i>IK është pamjaftueshëmria e zemrës për të pompuar debitin e duhur për nevojat indore, ka shkaqe dhe manifestime klinike të shumta. Ka trajtim kompleks.</i></p> <p><b>Tema 14.</b> Bronkiti akut dhe kronik, Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><i>Bronkitet janë procese inflamatorë të pareteve bronkiale, me shume shkaqe , manifestime me kollë, sekrecione dhe në vetvete janë shumë të përhapura.</i></p> <p><b>Tema 15.</b> Patologjitë pulmonare obstruktive.Semundja pulmonare obstruktive kronike - (SPOK) dhe Bronhektazia. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore, spirometria, rëndësia e testeve pulmonare</p> <p><i>Janë sëmundje obstruktive ku futen amfizema, bronkiti dhe që shoqërohen me të gjitha manifestimet klinike të secilës prej tyre si kollë, sputum, dispne.</i></p> <p><b>Tema 16.</b> Pneumonia virale dhe bakteriale. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore 168-172</p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 121-126</p> <p>Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 138-144</p> <p>Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 145-155</p> <p>Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 168-172</p> <p>Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
 FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Përbëjnë një grup të madh sëmundjesh pulmonare infeskioze akute dhe kronike me etiologji bakteriale dhe virale , më shpesh nga pneumokoku.</i></p> <p><i>Seminar 4: IK, bronkiti akut dhe kronik, SPOK, pneumonite</i></p>		<p><i>Seminar një orë</i></p> <p><i>Praktikë 5 orë</i></p>
V	<p><b>Tema 17.</b> Pneumonia e komunitetit dhe pneumonia nozokomiale. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore  <i>Përbëjnë një grup të madh sëmundjesh pulmonare infeskioze akute dhe kronike me etiologji bakteriale dhe virale që vijnë pas një periudhe shtrimi në spital, më shpesh nga MRSA.</i></p> <p><b>Tema 18.</b> Trombembolia pulmonare.Pneumotoraksi. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore  <i>Është mbyllja e menjëhershme e arteries pulmonare ose e një prej degëve të saj, nga embolia, janë aptologji të rënda dhe kërcënuese për jetën.pneumotoraksi është ajër në hapësirën pleurale</i></p> <p><b>Tema 19.</b> Insufiçenca respiratore akute dhe kronike. Patologjitë pulmonare që çojnë në insufiçencë respiratore.Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore 164-167</p> <p><i>Janë gjendje kërcënuse për jetën e pacientit, me shkaqe të ndryshme</i></p> <p><b>Tema 20.</b> Kanceri bronkopulmonar. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore 156-158</p> <p><i>Është patologji malinje me ecuri të shpejtë progressive, dominon tek meshkut dhe në vende të zhvilluara.</i>  <i>Seminar 5: pneumonite, tromboembolia, IAR, IKR, CA pulmonar.</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 168-172 Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 177-182 Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 164-167 Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 156-158 Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Seminar një orë</i></p> <p><i>Praktikë 5 orë</i></p>
VI	<p><b>Tema 21.</b> Astma bronkiale, Kriza e astmes bronkiale dhe Status astmatikus.Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore  <i>Është sëmundje alergjike kronike, me kollë, sputum shkumë, dispne, me karakter sezonal.</i></p> <p><b>Tema 22.</b> Reaksionet medikamentoze dhe alimentare.Anafilaksia dhe Shoku anafilaktik. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><i>Janë reaksione që shkaktohen nga barna të ndryshme kurse shoku anafilaktik është insufiçencë akute cirkulatore e shaktuar nga një alergji e shpejtë akute.</i></p> <p><b>Tema 23.</b> Urtikaria. Tipet i Hipersensibilitetit. Urgjencat alergologjike. Dermatitet e kontaktit.Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><i>Janë dukuri klinike të manifestuara me probleme në lëkurë si harta</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 212-218 Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 191-200 Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 195-200 Vëllimi I</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 201-208</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>gjeografike, locale ose të gjeneralizuara.</i></p> <p><b>Tema 24.</b> Hipofiza, akromegalia, gjigantizmi, prolaktinoma. iurënsufiçenca hipofizare, diabeti insipid. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Sëmundjet hipofizare janë të lidhura ngushtë me trurin dhe Hipotalamusin, duke bërë të mundur mekanizmin e fid bekut.</i></p> <p><i>Seminar 6: Azma. Sensibiliteti, urtikariet, reaksionet, crregullimet e hipofizes</i></p>	Vëllimi I	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Seminar një orë</i></p> <p><i>Praktikë 5 orë</i></p>
VII	<p><b>Tema 25.</b> Hiper dhe hipotiroidizmi. Kriza tireotoksike dhe koma miksedematoze. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore. Patologjitë hipofizare. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Gjendra tiroide ka veprim të brëndshëm sekretor, dhe hormone e saj derdhen në gjak. Është e lihur ngushtë me qarkullimin e gjakut.</i></p> <p><b>Tema 26.</b> Kanceri tioidien, hiper dhe hipoparatiroidizmi, Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><b>Tema 27.</b> Patologjitë suprarenale. Morbus Addison dhe kriza Adisoniene. Sindroma Cushing, Feokromacitoma. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Gjendrat suprarenale janë dy dhe prodhojnë tre hormone si cortizoli, aldosteroni dhe testosterone.</i></p> <p><b>Tema 28.</b> Diabeti mellitus. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Është sëmundje metabolike me dy tipe, dhe që trajtohet me medikamente ose insulin. Krijon problem eme popullsinë nga ana sociale dhe nga ana ekonomike, invalidizim dhe mortalitet të lartë.</i></p> <p><i>Seminar 7: problemet e tiroides, suprarenales, DM</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 228-229 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 234-235-240 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 240-250 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 251-261 Vëllimi II</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Seminar një orë</i></p> <p><i>Praktikë 5 orë</i></p>
VIII	<p><b>Tema 29.</b> Komplikacionet akute (Koma hipoglicemike, hiperglicemike, hiperosmolare). Komplikacionet kronike te diabetit mellitus, nefropatia dhe neuropatia diabetike. <i>Diabeti melitus ka shumë komplikacione akute nga shjaqe të shumtaqë janë vdekjeprurëse për individët. Kujdesi duhet të jetë maksimal si në trajtim ashtu dhe parandalim</i></p> <p><b>Tema 30.</b> Infeksionet urinare: Cistit akut dhe kronik. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore, egzaminimet radiologjike, mikrobiologjike, bakteriologjike. <i>Patologji që janë shumë të shpeshta, zanë vendin e dytë të patologjive, prekin cdo moshë dhe përsëriten shpesh.</i></p> <p><b>Tema 31.</b> Infeksionet urinare: Pielonefriti akut dhe kronik.</p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 267-287 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 269-275 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 273-275 Vëllimi II</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Janë patologji që prekin veshkën me tablo të rëndë me shënja të përgjithshme dhe locale.</i></p> <p><b>Tema 32.</b> Kalkuloza e rrugëve urinare. Kolika renale. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Janë patologji shumë të shpeshta që meritojnë vëmendje nga stafi mjekësor, me rreth 3000 raste të reja për 1 milion banorë, përmbledh një prokoll të gjërë trajtimi dhe parandalimi.</i></p> <p><i>Seminar 8: komplikacionet e DM, infeksionet urinare, kalkulozat e rrugëve urinare</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 65-78 Vëllimi II</p>	<p><i>Lexion një orë</i> <i>Seminar një orë</i> <i>Praktikë 5 orë</i></p>
IX	<p><b>Tema 33.</b> Glomerulonefritet akute. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Janë entitete klinike që vijn zakonisht pas një infeksioni akut streptokoksik dhe ka klinikë të të fshehur për disa javë, me simptoma të shumta dhe mjekim dietetic dhe antibiotiko terapi.</i></p> <p><b>Tema 34.</b> Glomerulonefritet kronike. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Janë infeksione shumë të shpeshta, më shpesh tek të rinjtë, dhe kanë tendenca për IRK.</i></p> <p><b>Tema 35.</b> Insuficenca renale akute. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>IRA e cilë është organike dhe nekrozë tubular është një sindrom që karakterizohet nga ndërprerja e papritur e funksioneve renale e shoqëruar me alteracione metabolike.</i></p> <p><b>Tema 36.</b> Insuficenca renale kronike, Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>IRK është fundi I të gjitha sëmundjeve renale kronike, me pasoja që karakterizohen më leziona renale të pakthyeshme me prishje totale të funksioneve renale.</i></p> <p><i>Seminar 9: GNA, GNK, IRA, IRK</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 49-58 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 59-65 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 89-94 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 99-108 Vëllimi II</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i> <i>Seminar një orë</i> <i>Praktikë 5 orë</i></p>
X	<p><b>Tema 37.</b> Ethja reumatizmale. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Është sëmundje reumatizmale e indit lidhor me pasoja të rënda kardiake sidomos në valvula duke sjellë dëmtim të përhershëm të tyre.</i></p> <p><b>Tema 38.</b> Artriti reumatoid. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Është sëmundje reumatizmale e indit lidhor me pasoja të rënda në artikulacionet e vogla me shënja inflamatore simetrike, prek të gjitha moshat më shpesh gratë.</i></p> <p><b>Tema 39.</b> Sklerodermia. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim</p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 109-116 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 117-130 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 23-26 Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>rasti në kartelën mjekësore</p> <p><b>Tema 40.</b> Lupusi eritematoz sistemik. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Patologji kolagjenoze e indit lidhor me karakter të diseminuar, prek më shumë femrat dhe ka komplekse immune tipike.</i></p> <p><i>Seminar 10: ethja, artiri, sklerodremia, lupusi</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 221-225 Vëllimi I <sup>(1)</sup>Fq. 232-235 Vëllimi I <sup>(1)</sup>Fq. 226-231 Vëllimi I</p>	<p><i>Lexion një orë Seminar një orë Praktikë 5 orë</i></p>
XI	<p><b>Tema 41.</b> Dermatomioziti. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Patologji kolagjenoze e indit lidhor, prek më shumë femrat dhe ka komplekse imune tipike.</i></p> <p><b>Tema 42.</b> Meningitet, encefalitet dhe çrregullimet e likuidit cerebrospinal (LCS). Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><b>Tema 43.</b> Cefalete, klasifikimi, karakteristikat, klinika, trajtimi. Studim rasti në kartelë mjekësore</p> <p><b>Tema 44.</b> Insultet cerebrale hemorragjike dhe trombotike. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Patologji të vecanta që prekin trurin me shkaqe të ndryshme.</i></p> <p><i>Seminar 11: dermatomioziti, meningitetm cefaleja, AVC</i></p>	<p><sup>(2)</sup>Fq. 232-235 Vëllimi I</p> <p><sup>(2)</sup>Fq37-39</p> <p><sup>(2)</sup>Fq126-130</p> <p><sup>(2)</sup>Fq103-113</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë Praktikë 5 orë</i></p>
XII	<p><b>Tema 45.</b> Koma dhe çrregullimet e vetëdijes. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Gjendje patologjike që ndokojnë në humbjen e funksioneve jetësore të pacientit me debilitim total social të familjes gjithashtu, me shkaqe të ënrsyhme dhe trajtim afatgjatë .</i></p> <p><b>Tema 46.</b> Tumoret intrakraniale. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Janë patologji metastatike, me etiologji të panjohur, që shfaqen me problem tek pacientet, humbje të funksioneve dhe prognozë jot ë mirë.</i></p> <p><b>Tema 47.</b> Epilepsia, klasifikimi, etiopatogjeneza, klinika, diagnoza, trajtimi. studim rasti në kartelën mjekësore <i>Patologji me klasifikime të ndryshme, kujdes afatgjatë dhe rëndësi të vecantë ka trajtimi I pacienti për gjithë jetën.</i></p> <p><b>Tema 48.</b> Demenca dhe Alzheimer dhe çrregullimet e gjumit, veçanërisht në moshat e treta. Studim rasti në kartelën mjekësore <i>Patologji që prekin funksionet jetësore të pacientit,</i></p> <p><i>Seminar 12: koma, tumoret kraniale, eoilepsia, demenca, alzhaimeri</i></p>	<p><sup>(2)</sup>Fq261-271</p> <p><sup>(2)</sup>Fq261-271</p> <p><sup>(2)</sup>Fq275-280</p> <p><sup>(2)</sup>Fq.18-21</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë Seminar një orë Praktikë 5 orë</i></p>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
XIII	<p><b>Tema 49.</b> Parkinsoni, etiopatogjeneze, klinike, diagnoze, trajtim. studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><b>Tema 50.</b> Polineuropatite dhe Iskiatiku. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><b>Tema 51.</b> Defiçiti motor dhe sensitiv i anësive. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore</p> <p><b>Tema 52.</b> Refluksi gastro-ezofageal, ezofagitet kaustike. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Këto janë patologji që prekin paretin e ezofagut duke shkaktuar discomfort tek pacienti dhe disfagi, kane trajtime conservative dhe kirurgjikale.</i></p> <p><i>Seminar 13: Parlinsoni, polineuropatite, deficitet motore, refluksi gastro ezofageal</i></p>	<p><sup>(2)</sup>Fq81-86</p> <p><sup>(2)</sup>Fq88-94</p> <p><sup>(2)</sup>Fq 99-103</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 213-216 Vëllimi II</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë Seminar një orë Praktikë 5 orë</i></p>
XIV	<p><b>Tema 53.</b> Semundja ulçeroze gastro-duodenale. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Është një patologji që prek pjesën gastrike dhe duodenale, më shumë preken meshkujt, ka shkaqe të ndryshme më I përhapur është H Piloni, ka trajtime afatgjata medikamentoze dhe dietetike.</i></p> <p><b>Tema 54.</b> Sindromi i kolonit të irrituar, koliti ulçeroz. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Është një patoogji me forma të ndryshme nga më e lehta tek më e rënda, me probleme të përgjithshme t ëpacientit, klinikë të shprehur në ushqyerje, rënie në peshë dhe trajtim afatgjatë medikamentoz dhe dietetic, higjenë dhe ndërhyrje kirurgjikale.</i></p> <p><b>Tema 55.</b> Morbus Crohn, sindromi i malabsorbimit. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Sëmundje inflamatore e sistemit GI me etiologji të panjohur por që prek pacientin nga ezofagu deri në anus, duke e debilituar gjendjen e përgjithshme të pacientit, me shume problem në diagnostikim, trajtim dhe prognozë të vështirë.</i></p> <p><b>Tema 56.</b> Pankreatiti akut dhe kronik. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Seminar 14: ulcerat G-D, koliti ulçeroz, mosbus chron, pankreatiti kronik dhe akut Praktikë 5 orë</i></p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 153-161 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 153-161 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 169-173 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 216-221 Vëllimi II</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë Seminar një orë</i></p>
XV	<p><b>Tema 57.</b> Hepatitet kronike. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore <i>Janë inflamacione kronike të heparit të karakterizuara me nekrozë të parenkimës hepatike.</i></p> <p><b>Tema 58.</b> Cirroza hepatike. Hipertensioni portal dhe encefalopatia</p>	<p><sup>(1)</sup>Fq. 217-219 Vëllimi II</p> <p><sup>(1)</sup>Fq. 185-189</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion një orë</i></p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
 FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>porto-kave, koma hepatike. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore  <i>Është sëmundje kronike me nekrozë të përhapur të qelizave hepatike, kolaps dhe ka lloje të ndryshme histoanatomike, shkaktohet nga alkoli, heaptitet virale, me një mjekim shumë të gjërë dhe eliminimin e shkaqeve të mundshme.</i></p> <p><b>Tema 59.</b> Kanceri i ezofagut, kanceri i stomakut, kanceri i kolorektal. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore  <i>Është shumë e shpeshtë, më shumë tek meshkujt, ka etiologji të panjohur, trajtimi është kirurgjikal.</i></p> <p><b>Tema 60.</b> Kanceri i pankreasit dhe i heparit. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi, studim rasti në kartelën mjekësore  <i>Janë patologji malinjë shumë të përhapura, metastatike, shumë të vështira për pacientin për tu rikuperuar me prognozë jo të mirë.</i></p> <p><i>Seminar 15: hepatitet, cirroza hepatike, CA ezofagu, CA pankreas dhe hepar</i></p>	<p>Vëllimi II  <sup>(1)</sup>Fq. 189-197            Vëllimi II  <sup>(1)</sup>Fq. 161-162            Vëllimi II            173-175            Vëllimi II  <sup>(2)</sup>Fq. 199-201            208-209</p>	<p><i>Lexion një orë</i></p> <p><i>Lexion 1 orë</i></p> <p><i>Seminar 1orë            Praktikë 5 orë</i></p>

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

<b>FREKUENTIMI:</b>	<p>Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët ue laboratorit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e laboratorit në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).            Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
<b>MËNYRA E VLERËSIMIT</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	temat 1/60	90 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar*	Java 14/15	raste klinike	10 pikë	prezantim me gojë	Raportim rasti/Demostrim procedure
	*Vlerësim i vazhduar - Detyra e kursit do të jetë në formën e një projekti që në fillim të semestrit. studentët do të përshkruajnë studime rastesh që kanë hasur në praktikat spitalore duke i krahasuar me materialet teorike për atë sëmundje. prazantimet do të kryhen në PPT.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:					
40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë	
5	6	7	8	9	10	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

LITERATURA

<b>Literatura bazë e detyruar</b>	<sup>(1)</sup> <i>Sëmundjet e brendshme I, II</i> , Fejzi Alushi 2008, ISBN: 99927-942-8-3 <sup>(2)</sup> Cikel leksionesh 'Infermiera e aplikuar në shëndetin mendor' – 2018 (Fakulteti i Shëndetit Publik - UV) Pergatitur dhe perkthyer nga Msc SonilaNikaj
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<i>Basic pathology</i> By Vinay Kumar, Stanley Leonard Robbins - Saunders/Elsevier (2007) - Hardback - 946 pages - ISBN 1416029737 <i>Pathology</i> By Edëard F. Goljan - Mosby Elsevier (2007) - Paperback - 739 pages - ISBN 032304414X <i>Diagnosis and evaluation in speech pathology</i> By William O. Haynes, Rebekah Hand Pindzola - Pearson/Allyn and Bacon (2008) -ISBN 020552432X • <i>Comprehensive radiographic pathology</i> By Ronald L. Eisenberg, Nancy M. Johnson - Mosby / Elsevier (2007) - ISBN 0323042198

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo pune me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.